



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 61, DATË 21.08.2020

**PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “ABC NEWS” SH.A., PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT AUDIO PRIVAT VENDOR “ABC
NEWS”**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria “Abc News” sh.a.

Objekt: Shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë “Abc News” sh.p.k., për rinovimin e licencës së subjektit audio privat vendor “Abc News”.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16, neni 68, pika “a” të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullorja “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, të ndryshuar,

VËREN

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) me vendimin nr. 120, datë 28.03.2011, ka licencuar shoqërinë “ABC News” sh.a., për subjektin audio privat “ABC News”. AMA me vendimin nr. 84, datë 16.05.2018, ka rinovuar licencën e këtij subjekti. Afati i vlefshmërisë së licencës ka përfunduar në datën 07.05.2019.

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregulloren “Mbi procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, të ndryshuar, si dhe në zbatim të urdhrit nr. 308, datë 20.11.2019, të Kryetarit të AMA-s, në datë 20.11.2019, u mbledh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, për të shqyrtuar aplikimin e shoqërisë “ABC News” sh.a., me nr. 3721 prot., datë 17.10.2019, për rinovimin e licencës së subjektit audio privat “ABC News”.

Aplikimi i subjektit rezultoi me mangësi në dokumentacion. Në këto kushte, AMA me shkresën nr. 3721/2 prot., datë 31.12.2019 dhe nr. 162/1 prot., datë 20.05.2020, kërkoi nga subjekti plotësimin e dokumentacionit.

Shoqëria "ABC News" sh.a., me shkresën nr. 162 prot., datë 21.01.2020, nr. 162/2 prot., datë 07.07.2020 dhe nr. 2045 prot., datë 27.07.2020, depozitoi dokumentacion plotësues. Pas shqyrtimit të dokumentacionit plotësues rezultoi se aplikimi është në përputhje me kërkesat e rregullores "Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio", miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, të ndryshuar.

Në përfundim KSHD, i propozoi AMA-s rinovimin e licencës së shoqërisë "ABC News" sh.a., për subjektin audio privat "ABC NEWS" dhe reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit nga "Rrethet Tiranë, Durrës, qyteti Fier dhe qarku Vlorë", në "Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Durrës dhe Shijak", me karakteristikat teknike përkatëse.

Pavarësisht sa më sipër, AMA vëren se bazuar në nenin 19, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 97/2013, të sipërcituar, parashikohet: "1. Funksionet kryesore të AMA-s janë:
b) lëshon dhe heq licencat dhe/ose autorizimet me shumicë të cilësuar;..."

Duke qenë se, AMA është organ kolegjal i përbërë nga Kryetari dhe 6 anëtarë, për të miratuar rinovimin e licencës së subjektit audio "ABC NEWS", nevojitet një shumicë e cilësuar prej 5 votash, shumicë, e cila nuk u plotësua gjatë votimit për aplikimin e shoqërisë "ABC NEWS" sh.p.k.

Neni 68 i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikon se: "Licenca... bëhet e pavlefshme kur... mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar".

Për sa më sipër, AMA arrin në përfundimin që aplikimi i shoqërisë "ABC NEWS" sh.a., për rinovimin e licencës së subjektit audio "ABC NEWS", duhet të rrëzohet,

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19 pika 16 dhe nenit 68, pika "a" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mosrinovimin e licencës së shoqërisë "ABC NEWS" sh.a., për subjektin audio privat vendor "ABC NEWS".
2. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë "ABC NEWS" sh.a., për subjektin audio privat vendor "ABC NEWS".
3. Shoqëria "ABC NEWS" sh.a., me njoftimin e këtij vendimi, ka detyrimin ligjor të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Zëvendëskryetar:

Anëtarë:

Gentian

Sami

Agron

Gledis

Suela

SALA

NEZAJ

GJEKMARKAJ

GJIPALI

MUSTA (Nuk mori pjesë në votim)